



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM**  
**“PËR ÇELJEN E GARËS PËR DHËNIEN E 1 (NJË) LICENCE TRANSMETIMI AUDIO ANALOGE”**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënie të licencës së transmetimit audio analoge”, miratuar me vendim nr. 7, datë 21.02.2023 të AMA-s, si dhe vendimit nr. 118, datë 11.11.2024 të AMA-s, “Për çeljen e garës për dhënie të licencave të transmetimit audio analoge”, do të organizojë procedurën e përzgjedhjes së kandidatave për dhënie të 1 (një) licence transmetimi audio analoge, të përbërë nga:

- licenca e shërbimit të programi audio;
- licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit analog.

Për zonën e mëposhtme:

Nr.	Zona e ofrimit të shërbimit	Përcaktimi i operatorit	Pikat e transmetimit	Frekuenca (MHz)
1.	Bashkia Gjirokastrë	Audio Analoge	Asim Zeneli	92.5

Subjektet e interesuara për t’u pajisur me licencë transmetimi audio analoge, janë të lutur që të depozitojnë aplikimet në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë, **brenda datës 23.12.2024, ora 10:00.**

Dokumentacioni i plotë i konkurrimit të kandidatave, që përfshin:

- Rregulloren “Për procedurat dhe kriteret për dhënie të licencës së transmetimit audio analoge”, e ndryshuar;
- Kërkesat që duhet të plotësojë aplikimi;
- Kriteret teknike për ofrimin e shërbimit audio përfshirë frekuencën/frekuencat dhe pikën/pikat e transmetimit për zonën e shërbimit;
- Pagesat për licencën, tarifatat përkatëse dhe mënyrën e pagesës së tyre;

mund të tërhiqet në zyrën e Arkivë-Protokollit, në AMA, pas kryerjes së pagesës në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve, nga çdo subjekt që synon të marrë pjesë në konkurrim.

Aplikimet do të hapen ***në datë 23.12.2024, ora 10:00, në mjediset e AMA-s***, ku subjektet aplikues apo përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në momentin e hapjes së dosjeve të aplikimit.